



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 8 Korrik 2023

Nr: 686

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**ZGJATJEN E AFATIT TË DENONCIMEVE NR. 402 ID DHE 403 ID PËR SHKELJE
ADMINISTRATIVE PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ
2023**

Në mbështetje të neneve 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f”, dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenit 7, pika 3, e vendimit nr. 9, datë 9.4.2021, “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre”, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

K O N S T A T O J :

Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për kundravajtjet administrative”, bazuar në përcaktimet e nenit 7, të vendimit nr. 9, datë 9.4.2021, “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:

-Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve fillon procedurën administrative dhe hetimin administrativ kryesisht me depozitimin e denoncimit në Portalin e Denoncimeve ose kur ajo mbërrin drejtpërdrejtë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

Data: 8 Korrik 2023

Nr: 686
Ora: 12:00



“Për zgjatjen e afatit të hetimit administrativ për denoncimet nr. 402 dhe 403 ID.”

-Afati që ka Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për shqyrtimin administrativ të denoncimit është jo më i gjatë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga paraqitja e tij.

-Afati i parashikuar në pikën 2, të këtij neni mund të zgjatet me vendim me shkrim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, kur çështja është komplekse ose është e nevojshme kryerja e hetimeve administrative shtesë.

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në datën 8.5.2023, është administruar shkresa nga raporti i Koalicini për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara, i regjistruar me nr. 402 ID, me lëndë *“Veprimtari e institucioneve publike”*, me objekt denoncimi *“Me Linditën, në mesin e shkrimtarëve, në ceremoninë e hapjes së edicionit të dytë të panairit të librit “Kamza Lexon”, me një larmishmëri aktiviteteve e emocioneve, i cili do të vijojë edhe në datat 6 & 7 Maj, me të pranishëm : Besnik Mustafaj (Politikan, diplomat, përkthyes dhe shkrimtar); Ben Blushi (Politikan, shkrimtar dhe gazetar); Namik Dokle (Politikan dhe gazetar); Të lumtur që Kamza për të dytin vit rradhazi promovon rëndësinë e librit në formimin dhe pasurimin kulturor . Ju ftojmë të na bashkoheni nesër me aktivitete dhe shkrimtarë të tjerë!”*

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në datën 8.5.2023, është administruar shkresa nga raporti i Koalicini për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara, i regjistruar me nr. 403 ID, me lëndë *“Veprimtari e institucioneve publike”*, me objekt denoncimi *“Me mjekët dhe infermierët e Klosit dhe Matit për të bashkëbiseduar për planin 2-vjeçar të rritjes së pagave që ka filluar të jetësohet dhe përmirësimin e infrastrukturës shëndetësore, për t’i krijuar stafëve mjekësore mundësinë për ta ushtruar me dinjitet profesionin e tyre fisnik. Gjithashtu zhvillimi i takimit është njoftuar edhe në Faqen Zyrtare të Internetit të Institucionit të Kryeministrit: “Klos, me mjekë dhe infermierë të përkushtuar të zonës për planin 2-vjeçar të rritjes së pagave dhe përmirësimin e infrastrukturës shëndetësore” , Është njoftuar edhe në Faqen Zyrtare të Internetit të Institucionit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale: “Rama-Manastirliu: Për mjekët e familjes rritje page me 20 mijë lekë dhe infermierët me 15 mijë lekë brenda 2024”. Në takim kanë qenë prezentë mjekë dhe infermierë të veshur me përparësen e bardhë. Gjithashtu në takim ka qenë edhe kandidatja e Partisë Socialiste për Kryetare në Bashkinë Klos znj. Valbona Kola, e cila në profesion është mjekë. Evidentohet se Ministrija e Shëndetësisë, në fund të fjalimit të saj është shprehur: “... Në fund dua të falënderoj nga zemra të gjithë ju, por veçanërisht daktoreshë Valbonën, e cila për 36 vite, së bashku me të gjithë ju këtu, ka ofruar kujdes shëndetësor për banorët e Klosit dhe tani do të marrë një stafetë të re për një mision të ri në shërbim të qytetarëve. Jo vetëm për sistemin shëndetësor por jam e bindur që një herë mjek e je gjithmonë mjek, nuk mund ta lësh këtë mision tëndin, por në shërbim të qytetarëve jam e bindur që do të bëjë akoma më shumë për Klosin që duam.”*

Edhe pse ka përfunduar afati 60 (gjashtëdhjetë) ditor i shqyrtimit të këtij denoncimi, hetimi administrativ është ende i papërfunduar, për shkak të kompleksitetit të çështjes objekt shqyrtimi.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “dh”, “f”, dhe “n” e pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenit 7, pika 3, e vendimit nr. 9, datë 9.4.2021, “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimeve regjistruar me nr. 402 ID dhe 403 ID.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Ilirjan CELIBASHI